



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 649/2 prot.

Tiranë, më 13.10.2025

VENDIM

Nr.42, datë 13.10.2025

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 33, DATË 15.9.2025**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 33, datë 15.9.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës dhe moskonfirmimin si nëpunës civil, në Njësinë Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”,

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i punonjësës **Lusiana Plaku**, e cila ka parashtruar pretendimin se vlerësimi për periudhën e provës në nivelin “jokënaqshëm” (4) dhe vendimi për moskonfirmimin si “nëpunës civil” janë në kundërshtim me përcaktimet e vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Për verifikimin e informacionit, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer hetimi administrativ i këtij rasti. Për këtë qëllim, Komisioneri ka kërkuar nga

institucioni, Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë të gjithë materialin shkresor që provon veprimet administrative të kryera për këtë rast.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me vendimin nr. 33, datë 15.9.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës dhe moskonfirmimin si nëpunës civil, në Njësinë Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.

Pas kalimit të afatit të përcaktuar në Vendimin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi, Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, ka informuar Komisionerin në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të këtij rasti.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 33, datë 15.9.2025, si dhe referuar informacionit të dërguar me shkresën nr. 1540 prot., datë 26.9.2025, me titull *“Kthim përgjigje*, regjistruar me tonën me nr. 623/8 prot., datë 3.10.2025, konstatoj se situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri, nëpërmjet pikave 1–3 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, ka kërkuar nga Administratori i Njesisë Administrative Baldushk të shpallë pavlefshmërinë absolute të aktit për moskonfirmimin në detyrë të punonjës Lusiana Plaku nr. 1068, datë 27.6.2025 dhe të përsërisë procesin e vlerësimit për periudhën e provës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës. Gjithashtu, është kërkuar që të përcaktohet qartë roli i zyrtarëve vlerësues dhe që Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë të ndjekë dhe të mbikëqyrë zbatimin e këtij procesi, si dhe të verifikojë praktikatat përkatëse edhe në njësitë e tjera administrative, me qëllim unifikimin e procedurave.

Vërej se me shkresën nr. 1540 prot., datë 26.09.2025, me titull *“Kthim përgjigje”*, Njësia Administrative Baldushk ka njoftuar Komisionerin se është informuar nga Bashkia Tiranë përmes shkresës nr. 31709 prot., datë 17.09.2025, se në lidhje me çështjen objekt verifikimi, punonjësja L. Plaku ka vijuar ndjekjen e procedurës ligjore përmes paraqitjes së një kërkesëpadie pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në këto kushte, vlerësoj se, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”*, si dhe në bazë të nenit 1, të ligjit nr.49/2012, *“Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, çështja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata dhe për këtë arsye, nuk ka më vend për të vijuar ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të caktuara në vendimin nr. 33, datë 15.9.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, (i ndryshuar), të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 33, datë 15.9.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës dhe moskonfirmimin si nëpunës civil, në Njësinë Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”, për shkak se çështja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata.
2. Për këtë vendim të njoftohet Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë dhe nëpunësja Lusiana Plaku.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha